

## STATUTI dhe AKT THEMELIMI

I

### SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUARA

**"Vital Care"**

**KREU I**

**HYRJE**

**Neni 1**

Sot ne daten,08.11.2021 Shoqeria me pergjegjesi te kufizuara "Vital Care" sh.p.kështë themeluar nga ortaket:

- **Genci Hodo**,I biri I Resultit,dtl. 21.08.1988,lindur ne Sarande,i identifikuar me nr personal te pashaportes I80821041U.

Themeluesit, të cilët janë madhorë, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, në përputhje me ligjin " Për Tregtaret dhe shoqëritë tregtare" hartojnë edhe statutin e Shoqërisë si më poshtë:

**KREU II**

**PERKUFIZIME**

**Neni 2**

Emertimi i shoqërise

Emertimi I shoqërisë është "Vital Care"

**Neni 3**

Asambleja e ortakëve ka vendosur miratimin e statudit të shoqërisë në bazë të legjislacionit në fuqi të Republikës së Shoqërisë, vecanërisht sipas ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008, "Për Tregtaret dhe Shoqëritë Tregtare" të ndryshuar, dhe si person juridik, e zhvillon aktivitetin në përputhje me këtë legjislacion dhe me normat e këtij statute. Ky statut hyn në fuqi pas regjistrimit në Qendrën Kombetare të Regjistrimit. Gjithashtu shoqëria e bazon aktivitetin e saj në ligjin nr. 9121, datë 28.07.2003 "Per Mbrojtjen e Konkurences" të ndryshuar, në Kodin Civil dhe Kodin e Punës si dhe në ligje të tjera në Republikën e Shqipërisë.

#### **Neni 4**

##### **Forma**

Shoqëria "Vital Care" sh.p.k është "Shoqëri me përgjegjësi të kufizuara"

#### **Neni 5**

##### **Selia**

1. Selia e Shoqërisë :Tirane,Rruga Selaudin Garbrani ,Brenda te Spitalit Amerikan
2. Vendi I mbajtjes së asamblesë së përgjithshme është selia e shoqërisë. Nëse bihet dakort me unanimitet, mbledhja e asamblesë mund të kryhet në një vënd tjetër.

#### **Neni 6**

##### **Objekti i Veprimitarisë së shoqërisë**

Objekti i veprimitarisë së shoqërisë do të jetë:

Sherbime Mjekesore.

#### **Neni 7**

##### **Vula e shoqërisë**

1. Shoqëria ka vulën e saj, në brëndësi të së cilës shkruhet I plotë emërtimi dhe forma e saj juridike.
2. Të gjitha aktet që dalin nga shoqëria, pasi nënshkruhen sipas ligjit, vulosen me vulën e shoqërisë.

#### **Neni 8**

##### **Kohëzgjatja e Shoqërisë**

Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë e pakufizuar dhe fillon nga momenti i regjistrimit të saj në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit me përjashtim të rasteve kur mbaron sipas parashikimeve në ligj ose kur vendos Asambleja e Përgjithshme.

#### **Neni 9**

##### **Veprimet e lejuara të shoqërisë**

Shoqëria mund të ndryshojë emërtimin, selinë, kohëzgjatjen dhe objektin e veprimtarisë së saj sipas vendimeve që do të marrë asambleja e Përgjithshme me shumicën e ortakeve që përfaqësojnë të paktën  $\frac{3}{4}$  e pjesëve të kapitalit.

#### **Neni 10**

##### **Marredhenia e punës**

1. Shoqëria për të kryer veprimtarinë s saj sipas objektit të këtij statute do të lidhë kontrata individuale për të rregulluar marrëdhëniet e punës.
2. Kontratat e punës do të lidhen konform ligjit " Kodi i Punës së Republikës së Shqipërisë" dhe dispozitave të tjera ligjore që rregullojnë marrëdhëniet e punës në Republikën e Shqipërisë.

#### **KREU III**

##### **PARIMI I DETYRIMIT TË BESNIKËRISË**

#### **Neni 11**

##### **Ndalimi, konflikti i interes dhe personat e lidhur**

1. Personi i autorizuar për të përfaqësuar ose mbikqyrur shoqërinë tregtare nuk mund të lidhë kontrata apo të hyjë në marrëdhënie të tjera me shoqërinë tregtare, nëse nuk deklarohen kushtet e veprimit, si dhe natyrën e objektin e interes të tij e veprimi nuk autorizohet paraprakisht prej të gjithë ortakeve ose të gjithë ortakëve të tjerë.
2. Cdo miratim paraprak dhe i përgjithshëm njoftohet për regjistrim në Qendrën Kombëtarë të Regjistrimit.
3. Miratimi i parashikuar jepet, gjithashtu, për cdo kontratë apo marrëdhënie tjetër, që shoqëria lidh me palë të treatë, e cila ka marrëdhënie personale apo financiare me personat e autorizuar për të përfaqësuar ose për të mbikqyrur shoqërine, apo me palë të tjera, marrëdhëniet e të cilave me personat e mësipër janë të lidhur që, nëmënyrë të arsyeshme, mund të ndikojnë vendimmarrjen e tyre në kundërshtim me interes e shoqërisë. Personat në vijim prezumohen të kenë një apo më shumë nga interes e mësipërm me personat e autorizuar për të përfaqësuar ose për të mbikqyrur shoqërinë:

- a. a) bashkëshorti/bashkëshortja, prindërit, vëllezërit ose motra e bashkëshortit/bashkëshortes;
  - b. b) fëmijët, prindërit, vëllezërit, motrat, fëmijët e fëmijëve ose bashkëshorti/bashkëshortja e personave të mësipërm;
  - c. c) personat e lidhur me personelin e autorizuar për të përfaqësuar ose për të mbikëqyrur shoqërinë. Persona të lidhur janë: të paralindurit ose të paslindurit, të afërmit në vijë të tërthortë të shkallës së dytë, birësuesi ose i birësuari, i afërmi i shkallës së parë i bashkëshortit/bashkëshortes;
  - d. d) një person, që banon me personin e autorizuar për të përfaqësuar ose për të mbikëqyrur shoqërinë.
4. Personat, të cilët kërkojnë miratim për një transaksion, sipas pikave 2 e 3 të këtij neni, nuk mund të marrin pjesë në votimin për miratimin e veprimit e nuk llogariten në kuorume.
  5. Cdo veprim që kërkon miratim, sipas pikës 2 dhe 3 të këtij neni, publikohet në pasqyrat financiare dhe raportet e ecurisë së veprimtarisë, së bashku me kushtet e veprimit, si dhe natyrën e objektin e interesit të personave të përfshirë.
  6. Për efekt të këtij statute, me persona të autorizuar për të përfaqësuar ose mbikëqyrur shoqërinë tregtare do të kuptojmë ortakët e shoqërisë, administratorin, ekspertin kontabël të autorizuar dhe likujduesin e shoqërisë.

## **Neni 12**

### **Parimi I Besnikërisë**

1. Gjat ushtrimit të të drejtave, ortakët veprojnë, duke marrë parasysh interesin e shoqërisë dhe të ortakëve të tjerë. I njëjti detyrim zbatohet edhe për administratorët.
2. Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në ligjose nga ky statut, në rrethana të tjera, ortakët gëzojnë të njëjtat të drejta, kanë të njëjtat detyrime e trajtohen në mënyrë të barabartë.

## **Neni 13**

### **Ndalimi I Konkurences**

1. Personat e autorizuar për të përfaqësuar ose mbikëqyrur shoqërinë tregtare nuk mund të mbajnë një pozicion drejtues apo të jenë të punësuar në shoqëri të tjera, që ushtrojnë veprimtari në të njëjtin sektorë ekonomik me shoqërinë e parë. Gjithashtu, këta persona nuk mund të mbajnë satusin e tregtarit për të ushtruar veprimtari në këtë sektor.

2. Ndalimi I përmëndur në pikën 1 të këtij neni të shfuqizuar nëpërmjet një autorizimi të posacem, të dhënë nga ortakët nga asambleja e përgjithshme me shumicë të kualifikuar.
3. Ndalimi I përmëndur në pikën 1 të këtij neni, të mbetur në fuqi edhe pas humbjes së cilësisë apo statutit të përmëndur në të, për një periudhë një vit pas humbjes së kësaj cilësie.
4. Nëse ndonjëri prej personave të përmëndur në pikën 1 të këtij neni shkel ndalimin e konkurrencës, shoqëria mund:
  - a) ta përrsashtojë atë nga shoqëria apo ta shkarkojë nga detyra;
  - b) të kërkojë ndërprerje të veprimtarisë konkurruese;
  - c) të ngrejë paqi për shpërblimin e dëmit.
5. Shoqëria, si alternativë të ngritjes së padisë për shpërblimin e dëmit, mund t'i kërkojësecilit prej personave të përmëndur në pikën 1 të këtij neni:
  - a) të pranojë se transaksionet e kryera për llogari të tij të kalohen për llogari të shoqërisë;
  - b) t'i transferojë shoqërisë të gjitha përfitimet që ka marrë nga kryerja e veprimeve për llogari të personave të tretë.
  - c) t'i transferojë shoqërisë të gjitha të drejtat e kreditë, që kanë rrjedhur nga kryerja e veprimeve për llogari të personave të tretë.
6. Padia për ushtrimin e të drejtave të shoqërisë ngrihet brënda tre viteve nga data e kryerjes së shkeljes. Për ngritjen e padisë ndaj personave të sipërpërmëndur zbatohen, gjithashtu, dispozitat e pikës 3 të nenit 10 të ligjit " Per tregtarët dhe shoqëritë tregtare".

#### Kreu IV

##### KAPITALI THEMALTAR – PJESMARRJA

1. Kapitali I shoqërisë ka vlerën 10.000(Dhjetë mijë ) lek I cili ndahet në 1 kuote.
2. Kapitali I shoqërisë mund të zmadhohet, me vendim të Asamblesë së Përgjithshme. Në rast zmadhimi të kapitalit nëpërmjet shtimit të kuotave të reja, ortakët kanë të drejtën e përparësisë në nënshkrim, proporcionalisht me shumën e kuotave të tyre, e drejtë nga e cila ata mund të heqin dorë.
3. Kapitali I shoqërisë, mund të zvogëlohet me vendim të Asamblesë së Përgjithshme. Zvogëlimi I kapitalit I prekë të gjithë ortakët në të njëjtën masë ndaj kuotave të kapitalit që ata përfaqësojnë. Kapitali nuk mund të zvogëlohet nën kufirin minimal që lejon ligji " Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare".

**Neni 15**  
**Kontributet**

Kapitali I shoqërisë, zotërohet nga ortakët e shoqërisë, si vijon:

Ortaku **Genci Hodo** zotëron 100 % të vlerës së kapitalit, të përbërë nga 1 kuote, me vlerë prej 10.000 (Dhjetë mijë) leke.

Vlera e kapitalit themeltar të shoqërisë është shlyer plotësisht me kontributin e ortakëve sipas raportit të paraqitur më sipër.

**Neni 16**  
**Kalimi i kuotave të kapitalit**

1. Kuotat e kapitalit të shoqërisë janë të kalueshme ndërmjet ortakëve dhe të kalueshme në rrugë trashëgimie. Trashegimtari paraardhësi ose pasardhësi, bëken ortakë, nëpërmjet kalimit të kuotave të kapitalit.
2. Kuotat e kapitalit të shoqërisë mund tu kalohen personave të tretë që nuk bëjnë pjesë në shoqëri, me vendimë të marrë me shumicën e ortakëve që përfaqësojnë të paktën  $\frac{1}{2}$  e pjesëve të kapitalit.
3. Në rast kur njëri apo disa nga ortakët dëshirojnë të kalojnë pjesërisht apo plotësisht, kuotat që ata zotërojnë në kapitalin e shoqërisë tek të tretët, më parë duhet që oferta për shitje tu behet ortakëve të tjerë të shoqërisë. Kur ortakët që gëzojnë të drejtën e parablerjes kanë dyshime rreth cmimit të kuotave të ortakut që kërkon ti kaloj ato, mund ti drejtohet gjykatës që të caktoj një ekspert vlerësues. Ortaku që kërkon kalimin e kuotave te të tretët duhet të lajmërohet në një afat sa më të shpejtë, nëse brenda 4 javëve ortakut nuk i jepet një përgjigje atëherë prezumohet se ortakët e tjerë kanë rënë dakort që kuotat e tij mund ti kalojnë të tretëve.
4. Kalimi i kuotave do të bëhet me kontratë.
5. Kuotat mund të pjesëtohen për shkak të kalimit të tyre.

**Neni 17**

1. Ortakët mbulojnë personalisht humbjet e shoqërisë deri në pjesën e pashlyer të kontributeve të nënshkuara.
2. Kontributet e ortakëve përbëjnë kapitalin e regjistruar të shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar.

**KREU V**  
**ORGANET E SHOQËRISE, KUORUMI DHE ZGJEDHJA E TYRE**

## Neni 18

### Asambleja e Përgjithshme

1. Cdo ortakë ka të drejtë të marrë pjesë në mbledhjet dhe vendimet e asamblesë së Përgjithshme, dhe disponon një numër votash të barabartë me kuotat e kapitalit që ai zotëron.
2. Ortaku mund të përfaqësohet në Asamblenë e Përgjithshme, në bazë të një autorizimi nga bashkëshorti ose një person tjetër i zgjedhur prej tij, me kusht që këta të jenë autorizuar me prokurë (përfshihet përfaqësimi i një ortaku nga një ortak tjetër apo administrator i shoqërisë).
3. Administratorët e shoqërisë nuk mund të veprojnë si përfaqësues të ortakëve në Asamblenë e Përgjithshme.
4. Autorizimi mund të jetë vetëm për një mbledhje të Asamblesë së Përgjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese në të njëjtin rend dite.
5. Asambleja e përgjithshme thirret nga administratorët, ekspertët kontabël të autorizuar, po qe se ka të tillë, nga likujduesit apo ortakët, të cilët përfaqësojnë të paktën 5 % të totalit të votive në Asamblenë e përgjithshme të shoqërisë. Këta ortakë mund të drejtojnë administratorëve një kërkesë me shkrim, përfshirë postën elektronike, për të thirrur Asamblenë e Përgjithshme dhe/ose përfshirjen e çështjeve të posaçme në rendin e ditës. Kërkesa duhet të përmbajë arsyet, objektivat dhe çështjet, për të cilat asambleja duhet të marrë një vendim. Nëse kërkesa refuzohet, këta ortakë kanë të drejtë ta thërrasin Asamblenë e Përgjithshme dhe të caktojnë çështjen e rendit të ditës. Njoftimi do të bëhet me shkresë ose nëpërmjet pastës elektronike.
6. Njoftimi me shkresë apo me mesazh elektronik duhet të përmbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës të u dergohet të gjithë ortakëve, jo më vonë se 7 ditë përpara datës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë.
7. Nëse në kundërshtim me pikën 5 të këtij neni, asambleja e përgjithshme nuk thirret, ose çështja e kërkuar prej tyre nuk futet në rendin e ditës, secili prej ortakëve, që ka bërë kërkesën, ka të drejtë të procedojë sipas ligjit në fuqi " Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare".
8. Lajmërimi për mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme rregullisht bëhet nga administratorët.
9. Asambleja e përgjithshme merr vendime për çështjet e mëposhtme dhe është përgjegjëse për to:
  - a) Përcaktimi i politikave tregtare të shoqërisë; ndryshimet e statutit;
  - b) Emërimin dhe shkarkimin e administratorëve të shoqërisë;
  - c) Emërimin e shkarkimin e likujduesve dhe ekspertëve kontabël të autorizuar;



- d) Përcaktimin e shpërblimeve për administratorët, likujduesit dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
  - e) Mbikqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë
  - f) Miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë (pas marrjes në shqyrtim të dokumentacionit përkatës).
  - g) Zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit (pas marrjes në shqyrtim të dokumentacionit përkatës);
  - h) Pjestimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
  - i) Përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë e në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
  - j) Riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
  - k) Miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
  - l) Cështje të tjera të parashikuara nga ligji;
10. Të gjitha vendimet të marra nga Asambleja e Përgjithshme rregjistrohen në një regjistër të vendimeve, të dhëna të cilat nuk mund të ndryshohen apo të fshihen.
11. Duhet rrugjistuar në vecanti, por pa u kufizuar në to, vendimet për:
- a) Miratimin e Pasqyrave Financiare Vjetore dhe të Raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
  - b) Shpërndarjen e fitimeve vjetore dhe mbulimin e humbjeve;
  - c) Investime;
  - d) Vendime për riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.
12. Vendimet e parregjistruara në regjistrin e vendimeve janë automatikisht të pavlefshme.
13. Sipas rëndësisë së vendimeve, mbledhja e asamblesë së përgjithshme mund të jetë e zakonshme ose e jashtëzakonshme.
14. Asambleja e përgjithshme vendos me shumicë të zakonshme për cështje të tilla si emërimi ose shkarkimi i administratorëve, ekspertëve kontabël të autorizuar dhe likujduesve, miratimi i raporteve të administrimit dhe të kontrollit, miratimi i pasqyrave financiare vjetore. Asambleja mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zotërojnë më shumë se 30% të kuotave dhe vendimet merren me më shumë se gjysma e votive të ortakëve pjesëmarrës.
15. Asambleja e përgjithshme vendos me shumicë të kualifikuar për cështje të tilla si ndryshimet e statutit, zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit themeltar, kalimi tek të tretët, zgjatja e kohës së veprimtarisë së shoqërisë apo likuidimi i saj, shndërrimi i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar në shoqëri të formave të tjera, ndarja e fitimeve si dhe cdo cështje tjetër që parashikohet në ligj. Marrja e vendimevetë vlefshme bëhet vetëm nëse ortakët që zotërojnë më shumë se 50% e kuotave janë të pranishme, votojnë me shkresë



apo mjete elektronike. Në këtë rast vendimet merren me  $\frac{3}{4}$  e votive të ortakëve pjesmarrës.

16. Në se asambleja e përgjithshme nuk mund të mbledhet për shkak të mungesës së kuorumit të përmendur në këtë pikë , të këtij neni, asambleja mbledhet përsëri jo më vonë se 30ditë, me të njëjtin rend dite.

#### **Neni 19**

##### **Administrimi**

1. Shoqëria administrohet nga një ose më shumë administrator të cilët janë persona fizikë të zgjedhur Brenda bashkësisë së ortakëve apo dhe jashtë saj.
2. Asambleja e përgjithshme emëron një ose më shumë persona fizikë si administratorë të shoqërisë. Afati I emetimit është 5 vjet, me të drejtë ripërtëritje, me përjashtim të rastit të dorëheqjes ose të shkarkimit të parakohshëm para mbarimit të afatit. Shkarkimi i administratorëve nga organi kompetent mund të bëhet në cdo kohë.
3. Emërimi I administratorëve prodhon efekt pas regjistrimit në Qendrën kombëtare të Rëgjistrimit.
4. Administratorët emërohen dhe shkarkohen me vendim të asamblesë së përgjithshme sipas parashikimit në këtë statut.

#### **Neni 20**

##### **Kompetencat e administratorëve**

1. Administratorët kanë të drejtë e detyrohen të:
  - a) Kryejnë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikën tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
  - b) Përfaqësojnë shoqërinë tregtare;
  - c) Kujdesen për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumentave dhe të librave kontabël të shoqërisë;
  - d) Përgatisin dhe nënshkruajnë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim;
  - e) Krijojnë një system paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat që kërcenojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
  - f) Krijojnë rregjistrime dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, sic parashikohet në ligjin Qëndrën Kombëtare të Rëgjistrimit ;
  - g) Raportojnë përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posacme me rëndësi të vecantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;

- h) Kryejnë detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut.
2. Administratorët janë të detyruar të thërrasin asamblenë e përgjithshme përsaparahikon ky statut ose ligji.
  3. Asambleja e përgjithshme mund të shkarkojë administratorin në cdo kohë me shumicë të zakoshme.

#### **Neni 21**

##### **Emërimi i Parë i Administratorëve**

Administratori i shoqërisë për periudhën 5-vjecare emërohet **Genci Hodo** me ID:180821041U I lindur ne Sarande I datlindjes 21.08.1988 .

]

#### **Neni 22**

##### **Ekspertë Kontabël të autorizuar**

1. Në rast nevoje si dhe kur kërkohet nga ligji, kontrolli financiar dhe aprovimi i llogarive vjetore kryhet nga një ekspert kontabël I autorixuar, I emëruar për dy vite financiare me mundësi rizgjedhjeje nga asambleja e përgjithshme me shumicë të zakonshme.
2. Shkarkimi I ekspertit kontabël të autorizuar vendoset në të njëjtat kushte si emerimi I tij, në rast se vërtetohen gabime, abuzime ose bëhet e pamundur kryerja e detyrës.

#### **KREU VI**

##### **VOTA**

#### **Neni 23**

##### **E drejta e votës**

Cdo kuotë jep të drejtën e një vote. Cdo ortak votat që ka mund ti japi vetëm në uniformitet.

#### **Neni 24**

##### **E drejta për të kaluar rezolutë**

Asambleja e përgjithshme mund të miratojë rezolutë pa plotësuar kriteret e njoftimit në këtë statut apo në ligj, Që të miratohet një rezolutë në mbledhjen e asamblesë së përgjithshme duhet të jenë të pranishme të gjithë ortakët personalisht dh eta votojnë atë në mënyrë të unifikuar.

#### **KREU VII**

##### **MARRËDHËNIET FINANCIARE**

#### **Neni 25**

## **Viti Financiar**

Cdo vit financiar fillon nga 1 Janar dhe përfundon më 31 dhjetor.

### **Neni 26**

#### **Bilanci Vjetor**

1. Bilanci vjetor, inventari, raportet mbi operacionet financiare dhe raportet e vecanta të hartuara nga administratorët dhe eventualisht nga eksperti kontabël I autorizuar, miratohen nga asambleja e përgjithshme e zakonshme.
2. Miratimi I dokumentave mbi veprimtarinë vjetore bëhen brënda një afati prej tre muajsh nga data e mbylljes së vitit financiar.
3. Gjuha që përdoret në miratimin e dokumentave është gjuha shqipe.

### **Neni 27**

#### **Dividentët**

Pas miratimit të llogarive vjetore dhe evidentimit të ekzistencës së fitimeve, asambleja e përgjithshme përcakton pjesën që u takon ortakëve në formën e dividentëve mbi fitimin në raport me kuatat që gjithsecili ka në shoqëri. Fitimi që do të ndahet ndërmjet ortakëve në raport me kuatat, përbëhet nga fitimi I vitit financiar të cilit I janë zbritur shumat e lena mënjane për fondin reserve të domosdoshëm (5% e fitimit të cdo viti, deri sa ky fond të arrijë vlerën 1/10 e kapitalit themeltar) dhe nga ana tjetër I janë zbritur ose I janë shtuar respektivisht humbjet apo fitimet e mbartura nga vitet e mëparshme.

### **Neni 28**

#### **Marredhenia me bankat dhe institucionet financiare**

Shoqëria ka të drejtë të hap llogari likuisuese pranë një ose më shumë bankave ose institucioneve financiare dhe të kryejë veprime likujduese pranë bankave. Në këto banka ose institucione financiare si nënshkrim I parë do të depozitohet ai I administratorit të shoqërisë, I cili duhet të nënshkruaj për të gjitha veprimet financiare në emër e për llogati të shoqërisë. Ai mund të autorizojë edhe persona të tjerë brënda shoqërisë.

### **Neni 29**

#### **Marrëdhënia me organet tatimore.**

Veprimtaria ekonomike e shoqërisë mbaron më 31 dhjetor të cdo viti. Administratori ose personat e caktuar prej tij janë të detyruar të paraqesin bilancin vjetor dhe deklarimin e të ardhurave , dhe ti dorzoj pranë organit përkatës të tatimeve.

## **KREU VIII NDRYSHIMI I STATUTIT TË SHOQËRISË**

### **Neni 30**

#### **Prishja e shoqërisë**

1. Shoqëria priset me perfundimin e afatit të përcaktuar, kur kjo vendoset nga ortakët si dhe kur janë arsyet e parashikuara në ligj.
2. Shoqëria nuk priset kur njëri prej ortakëve falimenton, bëhet i paaftë ose vdes, por vazhdon aktivitetin me ortakët e tjerë që kanë mbetur si dhe me trashëgimtarin e radhës së parë të ortakut të vdekur.

### **Neni 31**

#### **Likujdimi**

1. Shoqëria hyn në procesin e likujdimit që në momentin e prishjes së saj. Për kryerjen e këtij procesi asambleja emëron një likujdus, i cili i paraqet asaj raportin e likujdimit dhe afatin e nevojshëm të përfundimit të tij.
2. Në fund të procesit të likujdimit asambleja vendos me vendimin e ortakëve që zotërojnë të paktën  $\frac{3}{4}$  e kuotave të kapitalit mbi bilancin përfundimtar e financiar, mbi aktin e rregullueshmërisë së punës së likijduesit dhe për mbylljen e procesit të likujdimit.
3. Pas pagimit të kreditorve dhe shlyerjes së kuotave tek kontribuesit përkatës, likijduesi ndan kapitalet e mbetura ndërmjet ortakëve proporcionalisht me pjesët që ato zotërojnë në kapitalin themeltar.

### **Neni 32**

#### **Shndërrimi i shoqërisë**

Shndërrimi i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar në lloj tjetër shoqërie mund të kryhet vetëm me miratimin unanimit të ortakëve.

## **KREU IX DISPOZITA TË TJERA**

### **Neni 33**

#### **Mosmarrveshjet**

Të gjitha mosmarrëveshjet që mund të lindin gjatë ekzistences së shoqërisë ose gjatë periudhës së likuidimit midis ortakëve, ndërmjet shoqërisë dhe ortakëve, do t'i paraqiten për zgjidhje gjykatës së Rrethit Gjyqesor Tiranë.

Neni 34

Për çështjet që nuk janë parashikuar në këtë statut do të zbatohen dispozitat përkatëse të legjislacionit shqiptar në fuqi "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare".

Ky Statut nënshkruhet nga themeluesit.

THEMELUESIT E SHOQËRISE

Genci Hodo



